

UDHËZUES MBI MAKINERITË, IMPIANTET DHE PAJISJET

Ky Udhëzues u drejtohet punëdhënësve, menaxherëve dhe personave tjerë brenda vendit të punës që kanë një përgjegjësi për shëndetin dhe sigurinë.

Ky dokument duhet të përdoret si një ndihmë për sigurimin dhe përdorimin e sigurt të makinerive, impianteve dhe pajisjeve.



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija,

Rada i Trasfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers

Inspektorati i Punës/ Inspektorata Rada/ Labour Inspectorate

PËRMBAJTJA

HYRJE.....	1
FUSHËVEPRIMI DHE QËLLIMI	1
LE TË MËSOJMË PËR MAKINERITË, IMPIANTET DHEPAJISJET	2
RREZIQET NGA MAKINERITË DHE PAJISJET.....	3
MASAT E SIGURISË ME MAKINERI DHE PAJISJE	4
RREZIQET NGA IMPIANTI I NDËRTIMIT.....	7
DIZAJNI I SIGURT PËR IMPIANTIN E NDËRTIMIT	8
OPERIMI, INSPEKTIMI DHE MIRËMBAJTJA E SIGURT	8
VLERËSIMI I RISKUT PARA PËRDORIMIT DHE PAS PERIUDHAVE TË GJATA TË MOSPËRDORIMIT	9
AUDITIMET	9
VËREJTJET PËRFUNDIMTARE.....	9
SHTOJCA	10



HYRJJE

Makineritë, impiantet dhe pajisjet janë komponentë të rëndësishme fizik në të gjitha industrinë, p.sh., në prodhim, ndërtim, transport, bujqësi, etj. Ato u ndihmojnë njerëzve që me pak mund të arrijnë rezultate më të mëdha. Sidoqoftë, këto mjete shoqërohen edhe me rreziqe nga të cilat mund të lëndohen punëtorët ose mund të ndikojnë negativisht në shëndetin e tyre nëse nuk përdoren në mënyrë të sigurt. Nga ju, si punëdhënës kërkohet të veproni në përputhje me ligjet: Ligjin e Kosovës Nr. 04/L-161 (Siguria dhe Shëndeti në Punë), Ligjin Nr. 06/L-041 (Për Kërkesat Teknike për Produktet dhe Vlerësim të Konformitetit) dhe Rregulloren Nr. 02/2020 (Siguria e Makinerisë) për të dizajnuar, blerë dhe përdorur ato në mënyrë të sigurt pa iu shkaktuar dëm punëtorëve.

Makineritë, impiantet dhe pajisjet janë ndihma mekanike dhe instalime për të shndërruar kontributet në rezultate. Kontributi mund të jetë lëndë e parë, i cili mund të shndërrohet në gjysmë-produkt ose produkt përfundimtar, ose një energji që shndërrohet nga një formë në një formë tjetër. Ato ofrojnë përparësi të larta ekonomike në prodhimin masiv ose në ekzekutimin e projekteve të mëdha. Referojuni seksioneve pasuese për më shumë koncepte dhe udhëzime mbi rreziqet shoqëruese, masat parandaluese të sigurisë sa herë që ata duhet të përdoren nga forca njerëzore.



FUSHËVEPRIMI DHE QËLLIMI

Ky Udhëzues i dedikohet përkufizimit të Makinerive, Impianteve dhe Pajisjeve, identifikimin e rreziqeve shoqëruese, ngritjen e vetëdijes dhe sugjerimin e masave preventive dhe të kontrollit për ata që janë përgjegjës për prokurimin e sigurt, funksionimin, inspektimin dhe mirëmbajtjen e Makinerive, Impianteve dhe Pajisjeve në aktivitetet e përgjithshme të punës, përfshirë ndërtimin.

Ky dokument bazohet në praktikën më të mirë të pranuar ndërkombëtarisht në të gjitha llojet e vendeve të punës, me theks të veçantë në vendet e ndërtimit, si dhe është në përputhje me Ligjin e Kosovës 04/L-161 (Siguria dhe Shëndeti në Punë), Ligjin Nr. 06/L-041 (Kërkesat Teknike për Produktet dhe Vlerësimin e Konformitetit) dhe Rregulloren Nr. 02/2020 (Siguria e Makinerive).



LE TË MËSOJMË PËR MAKINERITË, IMPIANTET DHEPAJISJET

Makinë është një pajisje e prodhuar nga njeriu që përdor energji elektrike për të aplikuar forcë dhe kontrolluar lëvizjet në kryerjen e një veprimi. Makinaria është një grup makinash ose komponentësh të makinës(-ve). Makinaria më shumë ka të bëjë me pjesët e lëvizshme. Shembuj: makinë shtypëse, makinë paketimi, makinë plastike me presion të lartë, makinë shpuese, etj.



Impianti është një grup i makinave të ndërlidhura, statike dhe të lëvizshme, përfshirë tubacionet të cilat transformojnë kontributet në rezultate, p.sh. lëndët t para në gjysmë-produkte ose produkte përfundimtare. Ndonjëherë makineritë e mëdha dhe komplekse duken si një mini-impiant, nëse hyrjet-daljet e tyre janë mirë të dentifikuara.



Në sektorin e ndërtimit, “impianti” i referohet gjithashtu pajisjeve të mëdha të lëvizshme (ekskavatorë, buldozerë të ndryshëm, vinça të ndryshëm, kamionë, thërrmues, kamionë-cisternë me mekanizëm thithës te mbetjeve të lëngshme, lundra bartëse, nivelizues terreni, etj) dhe instalime për qëllime të caktuara të ndërtimit (mikserë dhe hedhëse betoni, rripa transportues te materialit, gjenerator, stacione karburanti, etj

Pajisjet janë një term i caktuar për emërtimin e makinerive (statike dhe lëvizëse) të cilat përbëjnë një Impiant.

Shembuj: shtylla, këmbyes, pompa, kompresorë, transformatorë elektrikë etj. në një impiant të kimikateve. Disa pajisje mund të jenë të pavarura, jo domosdoshmërisht pjesë të impiantit, për shembull, vinça ngritës ngarkese në një vend ndërtimi, ekskavatorë dhe makina shpimi.



Në industri, terminologjia e makinerive dhe pajisjeve përdoret në mënyrë të njëjtë.

Gjatë diskutimit në seksionet vijuese, kemi futur Makineritë dhe Pajisjet në një kategori dhe Impiantin e konstruktuar për qëllime të caktuara të ndërtimit në një tjetër kategori për të identifikuar rreziqet dhe për të sugjeruar masat parandaluese të sigurisë. Në përgjithësi, duhet të jemi të kujdesshëm gjatë fillimit ose ndalimit, inspektimit, riparimit, modifikimit, mirëmbajtjes, servisimit, pastrimit dhe transportimit të Makinerive/Impiantve/Pajisjeve.



RREZIQET NGA MAKINERITË DHE PAJISJET

Këto rreziqe mund të përmbliken si më poshtë:

- Punëtorët mund të lëndohen nga pjesët e lëvizshme apo materiali i hedhur.
- Pjesët e trupit të punëtorit gjithashtu mund të tërhiqen ose të bllokohen midis dhëmbëzorëve, disqeve të ndryshme rrotulluese, rripave, e të tjera të ngjashme.
- Skajet e mprehta mund të shkaktojnë prerje dhe lëndime serioze.
- Pjesët me maje mund të godasin ose shpojnë lëkurën e punëtorit dhe pjesët e sipërfaqes së vrazhdë mund të shkaktojnë djegie ose gërvishtje nga fërkimi.
- Punëtorët mund të shtypen sikur midis pjesëve që lëvizin gjithashtu edhe drejt një pjese fikse të makinës, murit ose objektit tjetër, dhe dy pjesë që kalojnë njëra pranë tjetrës mund të shkaktojnë gërvishtje.
- Pjesët e makinës, materialet dhe shkarkimet (të tilla si shkarkimi i gazit, avullit ose ujit) mund të jenë mjaft të nxehta ose të ftohta për të shkaktuar djegie ose përvëlime. Rrëshqitjet dhe pengimet mund të shkaktohen nga derdhja e vajit dhe lëngjeve të tjera.
- Energjia elektrike e përdorur për makineritë mund të shkaktojë goditje elektrike dhe djegie. Dridhjet e përsëritura mund të prodhojnë dëmtime të skeletit- muskujve për një kohë të gjatë. Pluhuri i prodhuar nga makineritë/pajisjet mund të ndikojë në frymëmarrje.
- Punëtorët mund të lëndohen për shkak të makinerive jo të besueshme të cilat zhvillojnë defekte për shkak të (mos)mirëmbajtjes së dobët ose kur makineritë përdoren në mënyrë të papërshtatshme për shkak të mungesës së përvojës ose trajnimit.
- Mund të ndodhin lëndime nga goditja prej makinerive të larta dhe pjesëve rezervë apo mjete tjera që bien.
- Disa makina/pajisje shkaktojnë zhurmë të papranueshme që çon në dëmtim të dëgjimit për një periudhë kohore.
- Kur kryhet analiza e sigurisë në punë/identifikim të rrezikut dhe analiza e rrezikut gjatë përdorimit ose punës në makineri/pajisje, do të mund të identifikohen më shumë rreziqe dhe mënyra për t'i kontrolluar ato, disa prej të cilave përshkruhen në seksionet vijuese të këtij Udhëzuesi. .






MASAT E SIGURISË ME MAKINERI DHE PAJISJE

Nën-seksionet e mëposhtme flasin për kontrollet parandaluese, lehtësimet, masat e sigurisë dhe reagimin ndaj emergjencave kur ndërveprohet me makineri dhe pajisje.

Të përgjithshme

Masat e duhura fizike (duke siguruar mbrojtës të përshtatshëm, pajisje mbrojtëse, shenja dhe pajisje paralajmëruese, pajisje kontrolli të sistemit, PMP) dhe masa të përshtatshme të mësimin (duke ndjekur sisteme të sigurta të punës, sigurimin e informacionit të duhur, udhëzimeve dhe trajnimeve në lidhje me makineritë/pajisjet specifike) duhet të merren paraprakisht

Para se të lejoni një punëtor të fillojë të përdorë ndonjë makinë/pajisje, mendoni për rreziqet ekzistuese dhe mënyrën se si ato mund të menaxhohen. Kontrolloni që makineria/pajisjet janë të kompletuara, me të gjitha masat mbrojtëse të vendosura dhe pa defekte.



Kujdesi ndaj prokurimit dhe dizajnit

Furnizuesi duhet të sigurojë mbrojtjen e duhur për makineritë/pajisjet dhe të informojë blerësit për çdo rrezik ("rreziqet e mundshme") për të cilat duhet të jenë të informuar përdoruesit për të menaxhuar kufizimet që kanë ato. Makineria e duhur për punën duhet të përzgjidhet. Makineritë duhet të jenë të shënuara me markën "CE" dhe të pajisen me një Deklaratë të Konformitetit dhe udhëzime në gjuhën e përdoruesve. Sigurohuni që kontrollet e funksionimit janë të dizajnuara dhe të siguruar për të shmangur funksionimin aksidental dhe dëmin që mund të shkaktohet. Makineritë/Pajisjet duhet të projektohen sipas standardeve/ligjeve të miratuara në fuqi. Makineritë dhe pajisjet duhet të projektohen në mënyrë ergonomike për të reduktuar lodhjen.

Instalimi

Çdo makinë statike dhe lëvizëse duhet të instalohet siç duhet, mbi një themel të fortë dhe të qëndrueshëm. Instalimi nuk duhet të jetë në një vend ku punëtorët e tjerë, klientët ose vizitorët mund të ekspozohen ndaj rrezikut.

Operimi

Një sistem i sigurt pune për funksionimin dhe zgjidhjen e problemeve të makinës duhet të jetë i themeluar. Makineritë/pajisjet e mundshme duhet të jenë të fikura, izoluar, mbyllura para se të ndërmerret ndonjë veprim për të hequr bllokimet operacionale, për të pastruar ose rregulluar makinerinë. Identifikoni dhe trajtoni rreziqet nga energjitë elektrike, mekanike, hidraulike ose pneumatike të përfshira në operacion:



- Kontrolloni për të vërtetuar se makineria është e mirëmbajtur dhe e përshtatshme për punë, funksionin si duhet dhe të gjitha masat e sigurisë janë në vend - mbrojtës, izolator, mekanizma bllokimi, ndërpresa të fikjes emergjente etj.
- Respektoni masat mbrojtëse: punëtorët konsiderojnë se masat mbrojtëse të krijuara keq janë të papërshtatshme për t'u përdorur dhe prandaj përpiqen t'i evitojnë ato, gjë që shpie drejt dëmtimeve , përfshirë edhe shkeljen e ligjit, që është e dënueshme. Kontaktoni me furnizuesin/projektuesin për të përmirësuar masat mbrojtëse, nëse është e mundur.
- Nëse mburojat statike nuk janë praktike , përdorni metoda të tjera, p.sh. rregulloni mburojat ashtu që makineria të mos mund të funksionojë nëse mburoja nuk është në vend. Në disa raste, duhet të përdoren sisteme pengimi të tilla si pajisje foto-elektrike, rrogoza të ndjeshme ndaj presionit ose mbrojtëse automatike nëse mbrojtës tjerë nuk janë të mundshëm . Sigurohuni që mbrojtëset e kontrollit janë të shënuara në mënyrë të qartë ashtu që të tregojnë se për çfarë shërbejnë ato.
- Sigurohuni që punonjësit kanë veshur PMP-të e duhura, të nevojshme për atë makinë, siç janë syzet e sigurisë, mbrojtja e dëgjimit dhe këpucët e sigurisë.
- Asnjëherë mos përdorni një makinë ose pajisje që ka të vendosur një shenjë ose etiketë rreziku. Shenjat e rrezikut duhet të hiqen vetëm nga një person i autorizuar, i cili mund të vlerësojë nëse makineria është e sigurt.
- Asnjëherë mos vishni bizhuteri të varura, veshje të lirshme, unaza. Nëse keni flokë të gjata, asnjëherë mos i leni të lëshuara, sepse mund të kapen nga pjesët që janë në lëvizje e sipër.
- Asnjëherë mos i shpërqendroni njerëzit që janë duke përdorur makineri.
- Parandaloni hyrjen në pjesët e rrezikshme (lëvizje, rrëshqitje, goditje, prerje, presion, nxehtësi, etj). Përdorni një kombinim të këtyre masave.
- Familjarizohuni me kontrollet e siguresave emergjente, siç janë kontrollet me dy duar (njëra dorë që nuk është në punë ndalon makinën, duke shtypur butonin e kuq, alarmin automatik).

Procedurat e punës/mbikëqyrja

Kontrolloni çdo rrezik të mundshëm duke i siguruar operatorit informacionin, udhëzime, procedura të punës dhe mbikëqyrjen e nevojshme.

Sistemi i ndriçimit/ergonomisë/ventilimit

Makineritë/pajisjet që do të përdoren duhet të jenë të ndriçuara mirë dhe të ajrosura mirë. Zona e punës dhe paraqitja e makinave dhe pajisjeve duhet të jenë ergonomikisht miqësore. Zona e punës përreth makinës duhet të mbahet e pastër dhe e rregullt, pa rreziqe pengesash dhe rrëshqitjesh.

Trajnimi

Trajnimi i duhur siguron që ata, të cilët përdorin makineritë/pajisjet, janë të aftë t'i përdorin ato në mënyrë të sigurt. Sigurohuni që ata të kenë aftësitë, njohuritë, përvojën dhe se janë të informuar rreth rreziqeve të duhura dhe se janë gjithashtu të përshtatshëm fizikisht për të kryer atë detyrë. Ndonjëherë nevojiten kualifikime zyrtare për makineri/pajisje specifike p.sh. vinç, shtypës, bluarje, saldim, pirunjerë, ekskavator, etj. Mos lejoni që njerëzit e paautorizuar, të pakualifikuar ose të pastërvitur të përdorin makineri/pajisje të tilla. Mos i lejoni kurrë fëmijët të veprojnë ose të ndihmojnë në makineri. Fillestarët, të rinjtë ose ata me aftësi të kufizuara, mund të jenë veçanërisht të rrezikuar dhe kanë nevojë për udhëzime, trajnime dhe mbikëqyrje.



Planifikimi i emergjencave

Bëni kontrolle ndalimi emergjent aty ku është e nevojshme, p.sh. butonat ne formë kokash të kërpudhave që janë lehtë të arritshme. Bëni stërvitje trajnimi për situatat emergjente, përfshirë shpëtimin e sigurt të punëtorëve.

Menaxhimi i ndryshimit

Nëse, për shembull, makineritë kontrollohen nga sisteme elektronike të programueshme, ndryshimet në çdo program duhet të kryhen nga persona kompetentë në mënyrë të sigurt. Mbani një regjistër të ndryshimeve të tilla dhe kontrolloni nëse atë janë kryer siç duhet. Asnjë ndryshim në makineri dhe pajisje nuk duhet të bëhet nga persona të paautorizuar.

Pajisjet e lëvizshme të punës

Respektoni masat specifike parandaluese në lidhje me pajisjet e lëvizshme të punës, p.sh. pirunjerë, kamionë, vinça, ekskavatorë, etj. Aty ku pajisjet e lëvizshme të punës përdoren për bartjen e njerëzve, siguroni përshtatshmërinë e tyre për këtë qëllim. Duhet të merren masa për të zvogëluar rreziqet (p.sh. përmbysjen). Për shembull, vinçat duhet të stabilizohen në mënyrë që të mos rrëzohen me ngarkesën. Kur jeni duke e përdorur një vinç, poziciononi impiantin e lëvizshëm në ingranazhe neutrale, vendosni frenat dhe bllokoni rrotat.



Riparimi, inspektimi dhe mirëmbajtja

Makineritë/pajisjet tuaja duhet të jenë të sigurta dhe prandaj duhet të planifikoni inspektim dhe mirëmbajtje të bazuar në rreziqe, me theks të veçantë në tiparet kryesore të sigurisë. Mendoni se cilat rreziqe mund të ndodhin nëse mjetet prishen gjatë përdorimit, nëse makineria fillon të punojë papritmas, nëse ndodh ndonjë kontakt aksidental me materiale të dëmshme, të cilat në rrethana normale duhet të jenë të mbyllura brenda makinës (për shkak të rrjedhjeve/thyerjeve/hedhjeve, etj.). Inspektimi dhe mirëmbajtja lejojnë që këto defekte të diagnostikohen herët, për të menaxhuar rreziqet. Sidoqoftë, inspektimi dhe mirëmbajtja duhet të planifikohen dhe kryhen në mënyrë korrekte për të ofruar sigurinë dhe besueshmërinë. Inspektimi dhe mirëmbajtja e pasigurt ka shkaktuar shumë raste fataliteti dhe dëme serioze ose gjatë mirëmbajtjes së tyre ose të atyre personave që kanë përdorur pajisjet e mirëmbajtura keq ose të mirëmbajtura/riparuara gabimisht. Sa më pak prishje të pajisjeve të mirëmbajtura do të thotë që do të ketë më pak kontakte të rrezikshme me makineri/pajisje dhe produktivitet dhe efikasitet më të mirë.

Procedura e raportimit të defekteve nga punëtorët të cilët mund të vërejnë probleme gjatë punës në makineri duhet të jetë e themeluar. Asnjëherë mos i injoroni raportet mbi pajisjet e dëmtuara ose të pasigurta. Planifikoni mirëmbajtjen për të minimizuar rrezikun për punëtorët e tjerë dhe personin e mirëmbajtjes kurdo që është e mundur. Planifikoni punën me kujdes para se të filloni. Përdorni Analizën e Sigurisë në Punë/Identifikimin e Rrezikut/Vlerësimin e Rrezikut nëse mirëmbajtja përfshinë punën në vende të pazakonta, p.sh. brenda hapësirave të kufizuara, në lartësi, nëntokë, pranë ujit ose në pjesë të pazakonta të ndërtesës.



Vendosja e shenjave dhe barrierave dhe pozicionimi i njerëzve në pikat kyçe është e nevojshme për të mbajtur larg njerëzit e tjerë.

Izolohuni nga Energjia: Sigurohuni që lëvizja e makinerive/pajisjeve është ndalur dhe se ato janë të izoluara nga burimet elektrike apo burimet e tjera të energjisë. Shumica e mirëmbajtjeve duhet të kryhen me fikje/zvogëlim të energjisë. Nëse puna është afër përçuesve elektrik te pa izoluar ajror, p.sh. afër vinçave të sipërm, ndërpriti energjinë e tyre së pari. Lironi çdo energji të ruajtur, siç është ajri i kompresuar ose presioni hidraulik që mund të shkaktojë lëvizjen e makinës. Lejoni që përbërësit që veprojnë në temperatura të larta të ftohen.

Sigurohuni që mirëmbajtja të kryhet nga persona kompetentë (punonjës ose kontraktorë) me aftësitë, njohuritë, përvojën, PMP-të e duhura dhe mjetet e nevojshme për të kryer punën në mënyrë të sigurt. Përdorni udhëzimet e mirëmbajtjes së prodhuesit dhe bëni një sistem të sigurt pune dhe qasjeje. Kjo do të zvogëlojë rreziqet dhe do të shmangë vonesat e paparashikuara.

RREZIQET NGA IMPIANTI I NDËRTIMIT

Incidentet në lidhje me shëndetin dhe sigurinë nga impiantet e ndërtimit të ndërtuara për qëllim të caktuar mund të grupohen në dy kategori:

1. Ato që ndodhin nga aksidentet e mëdha operacionale të tilla si shembja strukturore/përmbysja, etj., të cilat rezultojnë në ndërprerje të trafikut, zjarrit, derdhje/rrjedhje të dëmshme dhe lëndime/fatalitete.
2. Ato që ndodhin nga operimi, inspektimi dhe mirëmbajtja e makinerive dhe pajisjeve të përdorura në këto impiante.

Incidentet kryesore që përfshijnë impiante ndërtimi të ndërtuara për qëllime të caktuara tregojnë se ka diçka që nuk shkon me planifikimin operacional dhe ekzekutimin e këtyre impianteve, duke përfshirë kujdesin ndaj makinerive/pajisjeve të ndryshme (inspektim, mirëmbajtje, menaxhim të ndryshimit) dhe menaxhimin e njerëzve (kompetencat, trajnimi, reagimi emergjent, veprimet korrigjuese). Të gjitha incidentet e tilla duhet të raportohen, dhe shkaqet kryesore të identifikohen për veprime korrigjuese, përndryshe punëtorët do të kenë probleme të shëndetit dhe sigurisë.



DIZAJNI I SIGURT PËR IMPIANTIN E NDËRTIMIT

Siguria e impiantit të ndërtimit të ndërtuar për qëllim të caktuar fillon nga vetë faza e projektimit. Një dizajn i mirë i një impianti është garanci e mirë, për të siguruar që do të ketë incidente operacionale minimale, megjithatë, dizajnerët e impianteve presin që funksionimi, inspektimi dhe mirëmbajtja e një impianti do të jetë gjithashtu e mirë pa imrovizime apo kompromise.

Projektuesit e impianteve kur finalizojnë modelin e tyre zakonisht nisen nga premisa "Çka-Nëse" dhe përdorin studimin "HAZOP" (Rreziqet dhe Funkcionaliteti).

Përkundër përpjekjeve më të mira të projektuesve të impianteve dhe atyre të operatorëve, personelit të inspektimit dhe mirëmbajtjes, aksidentet operacionale ndodhin në jetën reale.

Për këtë arsye, dizajnerët caktojnë që, artikuj të tillë si mbrojtja, zonat e kufizuara, aparatet për fikjen e zjarrit, kutitë e ndihmës së parë, alarme emergjence etj., të vendosen vazhdimisht brenda ose afër impiantit për t'u përballur me emergjencat, veçanërisht ku ka rrezik nga rrjedhja e lëngjeve/gazrave të ndezshme, të cilat mund të shkaktojnë zjarr dhe shpërthim.



OPERIMI, INSPEKTIMI DHE MIRËMBAJTJA E SIGURT

Operatorët e impianteve të ndërtimit nuk duhet të tejkalojnë kornizën (parametrat) e funksionimit të impiantit siç përcaktohet në protokollet e projektimit. Nëse e bëjnë këtë, impianti mund të dështojë para kohe / apo në mënyrë të paparashikueshme derisa është në veprim, duke krijuar probleme të shëndetit dhe sigurisë.

Të gjitha masat preventive për të menaxhuar incidentet në impiantin e ndërtimit gjatë operimit, inspektimit dhe mirëmbajtjes duhet të trajtohen në të njëjtën mënyrë siç u diskutua në faqet e mëparshme nën Makineritë dhe Pajisjet.

Ju si punëdhënës duhet të planifikoni dhe mbani trajnime për personelin për funksionimin, inspektimin dhe mirëmbajtjen në fushat e tyre përkatëse, përfshirë reagimet emergjente.



VLERËSIMI I RISKUT PARA PËRDORIMIT DHE PAS PERIUDHAVE TË GJATA TË MOSPËRDORIMIT

Përveç inspektimit të rregullt para përdorimit, vlerësimi i riskut rekomandohet para se të përdorni ndonjë makineri, impiant dhe pajisje pas një periudhe të gjatë mospërdorimi, si një mënyrë e praktikës së mirë të sigurisë. Nëse ndonjë mjet është etiketuar si "i dëmtuar", mos e përdorni më.



AUDITIMET

Punëdhënësi duhet të ketë auditime të brendshme/vetë-inspektime sipas listës së sugjeruar të Shtojcës. Kjo do t'u mundësojë atyre që të menaxhojnë në mënyrë efektive shëndetin dhe sigurinë dhe gjithashtu t'i përgatisë ata për çdo auditim të jashtëm siç janë Rregullatori (Inspektorati i Punës etj.) dhe Certifikimi, nëse ka të tilla.

VËREJTJET PËRFUNDIMTARE

Mbani mend: makineritë, impiantet dhe pajisjet mund të jenë të rrezikshme dhe përdorimi jo i duhur dhe mirëmbajtja e dobët mund të çojë në incidente të shëndetit dhe sigurisë. Sidoqoftë, mos u shqetësoni! Ju mund të menaxhoni rreziqet duke ndjekur këtë dokument udhëzues.

Për më shumë informata, kontaktoni Inspektoratin e Punës.



SHTOJCA

Pyetjet e Auditimit të Punëdhënësit për “Energjinë Elektrike në Punë - Praktikat e Sigurta të Punës” (Dokumenti Udhëzues), siç është marrë nga dokumenti i listës së konsoliduar të kontrollit të Auditimit të SSHP të BE-së i zhvilluar në mars të vitit 2021, janë dhënë më poshtë.

U referohen seksioneve:

2.6.1. Kërkesat e përgjithshme të sigurisë për makineritë

2.3.3. Vendosja

2.3.4. Veprimet e përsëritura

2.6. 8. Puna me pajisje të rrezikshme (vinça, pajisje ngritëse, ashensorë, etj.)

3.3. Masat emergjente, ndihma e parë

1. A janë pajisjet e punës të vendosura në dispozicion të punonjësve në vendin e punës të përshtatshme për punën dhe qëllimin e tyre, në mënyrë që të mos vihen në rrezik siguria dhe shëndeti i punonjësve?
2. A garantojnë pajisjet e instaluara të punës kushte të sigurta të punës?
3. A është siguruar që pajisjet e punës me rreziqe të veçanta të përdoren vetëm nga personat të cilëve u është dhënë detyra t'i përdorin ato?
4. A janë mjetet e kontrollit që ndikojnë në siguri qartë të dukshme dhe funksionale?
5. A janë pajisjet e punës që paraqesin rrezik për shkak të rënies ose shkëputjes së objekteve, të pajisura me pajisjet e duhura të sigurisë që korrespondojnë me rrezikun?
6. A është makineria e projektuar dhe e ndërtuar në mënyrë të tillë që të shmangë çdo rrezik shpërthimi të vetë makinerisë ose të gazrave, lëngjeve, pluhurit, avujve ose substancave të tjera të prodhuara ose të përdorura nga makineria?
7. Kur ekziston rreziku i kontaktit mekanik me pjesët në lëvizje të pajisjeve të punës që mund të shkaktojnë aksidente, a janë ato të pajisura me barriera dhe pajisje mbrojtëse?
8. A kanë zonat dhe vendet e pajisjeve të punës ndriçim adekuat në përputhje me aktivitetin e tyre?
9. A janë pajisjet me temperaturë shumë të lartë ose shumë të ulët, kur është e përshtatshme, të mbrojtura për të shmangur rrezikun që njerëzit të vijnë shumë afër ose të vijnë në kontakt me to?
10. A kryhen operacionet e mirëmbajtjes vetëm kur pajisja është e fikur ose vetëm kur janë marrë masat preventive të sigurisë?
11. A posedojnë pajisjet/makineritë shenja dalluese dhe mjete paralajmëruese?
12. A kanë zonat ku qëndrojnë punonjësit dhe personat e tjerë afër pajisjeve të punës gjatë proceseve të prodhimit, riparimit dhe mirëmbajtjes, qasje të sigurt dhe vende të sigurta për pushim?
13. A posedojnë pajisjet e punës sistem komandues për fikjen e tyre të plotë?
14. A janë marrë masat e nevojshme të sigurisë për pajisjet që lëvizin vetë dhe që mund të paraqesin rrezik për punëtorët?
15. A janë marrë masat e nevojshme të sigurisë për pajisjet që janë në rrezik zjarri?
16. A janë mjetet e telekomanduara të sigurta për t'u përdorur?
17. A janë pajisjet ngritëse të instaluara përhershëm dhe stabile?
18. A merren masat e nevojshme për të shmangur ose zvogëluar rrezikun e ndikimit nga ngarkesat gjatë ngritjes kur punoni me pajisje ngritëse të instaluara përhershëm?
19. A janë pajisjet e punës për ngritjen ose lëvizjen e punonjësve të sigurta për t'u përdorur?



20. A kryhen mirëmbajtja teknike e mjeteve dhe pajisjeve, si dhe korrigjimi sa më shpejt i mundshëm i çdo mosfunksionimi ose defekti që kërcënon sigurinë dhe shëndetin e punonjësve në vendin e punës?
21. A bëhen inspektimet/kontrollet e veçanta të pajisjeve të punës nga persona kompetentë të cilët posedojnë kualifikimet e nevojshme?
22. A janë vendosur procedurat e sigurisë dhe a janë dhënë udhëzimet për funksionimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të punës që mbajnë rreziqe.
23. A janë pajisjet ngritëse të instaluara në mënyrë të përhershme të operuara nga personel i kualifikuar dhe me përvojë për këtë punë?
24. A është bërë një vlerësim i rrezikut në vendin e punës dhe a janë të punësuarit të pajisur me pajisje mbrojtëse personale sipas vlerësimit të rrezikut?
25. A Keni marrë masa të përshtatshme organizative dhe teknike për të shmangur nevojën për punë në pozita të zgjata apo të vështira?
26. A është kryer vlerësimi i riskut për proceset e punës që kërkojnë punë në pozita të sforcuara?
27. A ka pasur konsultime me punonjësit (dhe përfaqësuesit e tyre) në lidhje me punën që kërkohet në pozita të zgjata ose të vështira?
28. A janë analizuar të gjitha proceset e punës dhe detyrat ku kërkohet punë në pozita të sforcuara të krahëve/duarve për më shumë se 30 minuta dhe, nëse është e nevojshme, të sigurohen masa preventive?
29. A janë marrë masat e duhura organizative dhe teknike për të shmangur nevojën për detyra dhe lëvizje të përsëritura?
30. A është kryer vlerësimi i riskut për proceset e punës që kërkojnë lëvizje të përsëritura?
31. A është siguruar informacion dhe trajnim i mjaftueshëm për punonjësit në lidhje me rreziqet dhe masat parandaluese për detyrat e punës me lëvizje të përsëritura?
32. A është marrë parasysh që organizimi i vendit të punës dhe pozita e punës së operatorëve duhet të jenë ergonomike?